

PLANI I THJESHTE I PERENDISE PER SHPETIM

Shoku im: Po të drejtoj pyetjen më të rëndësishme të jetës. **Gëzimi ose hidhërimi yt për gjithë përjetsinë varet nga përgjigjja jote.** Pyetja është: A jeni i shpëtuar? Pyetja nuk është sa i mirë jeni, apo nëse jeni anëtar kishe, por a jeni i shpëtuar? **A jeni i sigurt se do të shkoni në Parajsë kur të vdisni?**

Zoti thotë se që të shkoni në Parajsë, ju duhet të rilindeni. Tek Gjoni 3:7, Jezusi i tha Nikodemit; **“Duhet të lindni përsëri.”**

Në Bibël, Zoti na tregon planin se si mund të rilindemi, që do të thotë, të shpëtohem. Ky plan është i thjeshtë. **Ti mund të shpëtohesh sot.** Si?

Së pari, shoku im, ti duhet ta kuptosh që **je një mëkatar.** **“Të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”** (Romakëve 3:23).

Per shkak se je një mëkatar, **ti je dënuar me vdekje.** **“Sepse paga e mëkatit është vdekja”** (Romakëve 6:23). **Kjo përfshin ndarje të përjetshme nga Zoti në Ferr.**

“... është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjyqi” (Hebrenjve 9:27).

Por Zoti të deshi ty kaq shumë sa që **Ai dha birin e tij të vetëm, Jezusin, për të marrë mëkatet e tua dhe të vdiste në vendin tënd.** **“Ai bëri të jetë mëkat për ne ai (Jezusi) që nuk njihje mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të”** (2 Korintasve 5:21).

Jezusi duhej ta derdhte gjakun e tij dhe të vdiste. **“Sepse jeta e mishit është në gjak”** (Leviticu 17:11). **“...pa derdhje gjaku nuk ka falje”** (Hebrenjve 9:22).

“Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne” (Romakëve 5:8).

Ndonëse ne nuk mund ta kuptojmë si, Zoti tha se **mëkatet e tua dhe mëkatet e mija u vendosën mbi Jezusin dhe Ai vdiq në vendin tonë.** Ai u bë zëvendësuesi ynë. Kjo është e vërtetë. Zoti nuk mund të gënjejë.

Shoku im, **“Perëndia . . . tani urdhëron njerëzit kudo të pendohen”** (Veprat e Apostujve 17:30). **Ky pendim është një ndryshim i mendjes që bie dakord me Zotin që të gjithë janë mëkatarë dhe bie dakord me atë që Jezusi bëri për ne në kryq.**

Në Veprat 16:30-31, rojtari filipian pyeti Palin dhe Silan: **“Zotërinj, çfarë duhet të bëj unë për të shpëtuar?”** **Dhe ata thanë: “Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh.”**

Thjeshtë besoni në të si i vetmi që mori mëkatet e tua, vdiq në vendin tënd u varros dhe të cilin Perëndia e ringjalli.

Ringjallja e tij fuqimisht na siguron se besimtari mund të thotë se zotëron jetën e përjetshme kur Jezusi është pranuar si shpëtimtar.

“Por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij” (Gjoni 1:12).

“Kushdo që do të thërrasë emrin e Zotit do të shpëtohet” (Romakëve 10:13).

Kushdo të përfshin edhe ty. Do të shpëtojë do të thotë jo ndoshta, ose mund, por do të shpëtojë.

Sigurisht, ti e kupton që je një mëkatar. Në këtë çast kudo që je, duke u penduar, çoje zemrën para Zotit në lutje.

Tek Luka 18:13 një mëkatar u lut: **“Perëndi, ki mëshirë për mua, mëkatarin.”**

Lutu thjesht: **“Oh Zot, e di që jam një mëkatar. Besoj se Jezusi udiq në kryq në vendin tim. Besoj se derdhja e gjakut të tij, vdekja, varrimi dhe ringjallja e Tij ishin për mua. Tani e pranoj atë si shpëtimtarin tim. Të falenderoj për faljen e mëkateve të mia, për dhuratën e jetës së përjetshme nga hiri yt i mëshirshëm, Amen.”**

Pranoje Perëndine sipas fjalës së tij dhe kërkoje shpëtimin e tij me anë të besimit. **Beso, dhe do të shpëtohesh.** As kisha, as ndonjë organizatë, as veprat e mira nuk mund të të shpëtojnë. **Mbani mend se Perëndija sjell shpëtimin. Vetëm Ai!**

Plani i thjeshtë i Perëndisë për shpëtim është: ti je një mëkatar. Prandaj, në qoftë se ti nuk beson tek Jezusi i cili vdiq në vendin tënd, ti do ta kalosh përjetësinë në ferr. Në qoftë se beson tek Ai si shpëtimtari yt i kryqëzuar, varrosur dhe i ringjollur, ti do të marrësh faljen e të gjithë mëkateve të tua dhe **dhuratën e tij të shpëtimit të përetshëm me anë të besimit.**

Ju thoni, “Padyshim nuk mund të jetë kaq e thjeshtë.” Po, kaq e thjeshtë është! Ky është sipas shkrimit të shenjtë plani i Perëndisë. **Miku im: Beso tek Jezusi dhe pranoje atë si shpëtimtar sot.**

Nëse plant i tij nuk është shumë i qartë, **lexoje këtë fletë pa pushim, pa e hequr nga dora derisa ta kuptosh atë.** Jeta jote është më e vlefshme se bota.

“Ç’doi do të ketë njeriu të fitojë gjithë botën, nëse më pas do të humbë frymen e vet?” (Marku 8:36).

Sigurohu që je i shpëtuar. Në qoftë se humbet frymen tënde, humbet Parajsën dhe gjithçka. Të lutem! **Lejoje Perëndinë të të shpëtojë ty në këtë moment.**

Fuqia e Perëndisë do të shpë toje ty, do të të mbajë të shpëtuar dhe do të të bëjë në gjendje ty për të jetuar një jetë fitimtare Kristiane. **“Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë rrugëdalje, që ju të mund të përballoni”** (1 Korintasve 10:13).

Mos i besoni ndjenjave tuaja. Ato ndryshojnë. Qëndroni në premtimet e Zotit. Ato nuk ndryshojnë asnjëherë. Pasi të shpëtohesh janë tri gjëra për ti praktikuar çdo ditë për rritje shpirtore: Lutu – ti flet me Perëndinë. Lexo Biblën tënde – Perëndia të flet ty. Dëshmo – ti flet për Perëndinë.

Ti duhet të pagëzohesh në bindje ndaj Zotit Jezu Krisht si një dëshmi publike e shpëtimit tënd dhe pastaj të bashkohesh me një kishë që beson Biblën, pa vonesë. “Mos ki turp, pra, të dëshmosh Zotin tonë . . . ” (2 Timoteut 1:8).

“Kushdo që do të më rrëfejë (dëshmon) përpara njerëzve, edhe unë do ta rrëfej përpara Atit tim që është në qiell” (Mateu 10:32).